

Rekomandimet e OSBE/ODHIR: Zgjedhje parlamentare 2021

Rekomandime te tjera

Nr	Rekomandimi i OSBE /ODIHR	Statusi i implementimit	Komente dhe shënime të tjera
18	Duhet të zhvillohet aftësia e KQZ-së për të zbatuar në mënyrë efektive kërkesat ligjore në lidhje me mbikëqyrjen e financimit të fushatës.	Progres i Munguar	Megjithë kërkesat në vazhdim të artikuluara nga organizata të shoqërisë civile, kërkesa që konvergjojnë me këtë rekomandim të OSBE/ODIHR aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë nismë mbështetëse për zhvillimin e kapaciteteve të KQZ për mbikëqyrjen e financimit të fushatës zgjedhore. Shtesat e bëra në Kodin Zgjedhor në të cilat trajtohet problemi i monitorimit, në kohë reale, i shpenzimeve të partive politike për fushatën zgjedhore, duke mos u shoqëruar edhe me mbështetjen për zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme që duhet të ketë KQZ-ja kanë rezultuar jo efektive.